



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANËS
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. _____ prot

Tiranë më, ____, ____, 2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE
TË ANKIMIT**

Drejtuar: Operatorit ekonomik: “Bajro Bros” shpk

NIPT-t: M113130290

Adresa: Rr. Ndre Mjeda, Kompleksi rezidencial “Magnet”, Pallati Lura, njesi sherbimi nr.1017 , Tiranë.

OE/BOE me nënkontraktor

PO **JO**

Nëse po, të jepen dhënat: **Nuk ka nënkontraktor**

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO **JO**

Nëse po, të jepen dhënat: **Nuk ka subjekt mbështetës**

* * *

Tipi i Kontratës: **Kontratë për Mallra**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **Nr. REF-33041-12-12-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Blerje materiale specifike**

Kohëzgjatja e kontratës: Afati i lëvrimit të mallit do të jete 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: *Data 08.01.2025*

¹Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit *Buletini Nr.1 date 13 Janar 2025*

KRITERET KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Bajro Bros” shpk NIPT-t: M113130290

Vlera e ofertës: 937,460.25 (nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë pikë njëzetë e pesë) leke pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO **JO**

Nëse po, të jepen dhënat: **Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës.**

Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

2. Operatori ekonomik “GE-D” shpk

NIPT-t: M11307042L

Vlera e ofertës: 944,000 (nëntëqind e dyzetë e katërmijë) lekë pa Tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës.**3. Operatori ekonomik “Biotek” shpk**

NIPT-t: L82203011N

Vlera e ofertës: 1,054,054 (njëmilion e pesëdhjetë e katërmijë e pesëdhjetë e katër) lekë pa Tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës.**4. Operatori ekonomik “A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP” shpk**

NIPT-t: L72230026K

Vlera e ofertës: 1,100,010 (njëmilion e njëqind mijë e dhjetë) lekë pa Tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës.**5. Operatori ekonomik “POWER INDUSTRIES” shpk**

NIPT-t:

L51706022H

Vlera e ofertës: 1,154,610 (njëmilion e njëqind e pesëdhjetë e katërmijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë pa Tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës.**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:****1. Operatori ekonomik “GE-D” shpk**

NIPT-t: M11307042L

Vlera e ofertës: 944,000 (nëntëqind e dyzetë e katërmijë) lekë pa Tvsh

për arsye e mëposhtme

Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit, “Blerje materiale specifike” përcaktohet kriteri si më poshtë:
Ofertuesi deklaron se:

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

Në përmbushje të kriterit më sipër, operatori ekonomik ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

-Formular përmbledhës i vetëdeklarimit sipas shtojcës 9, të operatorit ekonomik “GE-D”shpk;

*-Ekstrakt historik i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”; Në nenin 76, “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: 1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:
a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e*

armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
dh) falsifikim;
e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...” Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që: “Ofertuesi deklaron se: ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së”. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “GE-D” shpk për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i vlerësimit të ofertave konstaton, se operatori ekonomik nuk ka përmbushur kriterin për deklarimin e personit/ave që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i/janë të dënuar ose nuk ka qenë i/të dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “GE-D” SHPK, mbi plotësimin e Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, si dhe informacionit të marrë nga Ekstrakti i Rregjistrimit Tregtar, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “GE-D” shpk nuk ka plotësuar me të gjithë të dhënat e duhura, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në përmbushje të kriterit ku ofertuesi deklaron personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së”. Operatori ekonomik nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit administratorin dhe ortakun Enzo Muho. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kritereve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik

“GE-D” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura duke e shpallur ofertë të pavlefshme

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës.

2. Operatori ekonomik “A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP” shpk NIPT-t: L72230026K

Vlera e ofertës: 1,100,010 (një milion e njëqind mijë e dhjetë) lekë pa Tvsh

për arsyet e mëposhtme

a) të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon: 1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; perkatësisht në vlerën: **24,998,94 (njëzet e katërmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë nëntëdhjetë e katër) lekë pa tvsh të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse**

Në seksionin 3 “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike” pika 3.1 “Sigurimi i ofertës”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon: 3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150(shprehur në ditë)

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik “AKM Albanian Investment Group” ka paraqitur sigurimin e ofertes me Nr.serie 244108785, datë 24.12.2024 në të cilin parashikohet se: “[...] Ky sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në njoftimin e kontratës që është 30 ditë.[...]”.

Ne Udhezime per operatoret ekonomike percaktohet specifikisht:

Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontrates pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.

Sa më sipër operatori ekonomik ka paraqitur periudhë më të shkurtër vlefshmërie se periudha e kërkuar në dokumentat e tenderit dhe për rrjedhojë sigurimi i ofertës nuk është i vlefshëm. Komisioni i vleresimit të ofertave gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

b) Në pikën 2.1.1, të shtojcës 7, “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

2.1.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e vlefshme) “Sistemet e menaxhimit të cilësive” e cila të përfshijë objektin e prokurimit (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO).

Të gjitha certifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues.

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik “AKM Albanian Investment Group” ka paraqitur ISO 9001:2015 me Nr. 0258C2023 e cila është e papërkthyer në gjuhën shqipe sikundër përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në nenin 40 “Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në udhëzimet për operatorët ekonomikë përcaktohet në Seksionin 1 Udhëzime për operatorët ekonomikë, Seksioni B “Pergatitja e ofertave” pika 2 “Gjuha e ofertës” përcaktohet me poshte :

Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.

Në shtojcën Njoftimi i kontratës, Seksioni 4: Procedura është përcaktuar

Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip **Anglisht**

Pra certifikata ISO 9001:2015 nuk është paraqitur në gjuhën e përcaktuara nga autoriteti kontraktor për hartimin e ofertave dhe gjithashtu as nuk është e shoqëruar nga një përkthim zyrtar në gjuhën e specifikuar në njoftim.

3. Në dokumentat e tenderit “Kriteret e veçanta për kualifikim”, Kapaciteti teknik, pika 2.3.1 përcaktohet sa më poshtë:

2.3.1. Dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, me objektin e prokurimit të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës me vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate dhe konkretisht: 249.989.4 (dyqind e dyzet e nënëtmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë pikë katër) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “AKM Albanian Investment Group” shpik konstatohet se në plotësim të këtij kriteri ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

1. Vërtetim realizimi kontrate me ujesjelles kanalizime Tirane sha.
2. Fatura të furnizimit të mallit.

Referuar kriterit sa më sipër përcaktuar operatori ekonomik në rastin e furnizimeve të realizuar me institucione shtetërore duhet të paraqiste kontratën shoqëruar me vertetim realizimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohet se operatori ekonomik ka paraqitur vertetimin e realizimit dhe faturat por nuk ka paraqitur kontratën e lidhur me Ujesjelles kanalizime, Tiranë sha. Komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “AKM Albanian Investment Group” shpk nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi ky operator ekonomik nuk e plotëson kërkesën për kontratat e ngjashme sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, Kriteret e vecanta për kualifikim pika 2.3.1. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “AKM ALBANIAN INVESTMENT GROUP” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura **duke e shpallur ofertë të pavlefshme**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor, nuk ka subjekt mbështetës.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**Bajro Bros**” shpk me Adresa: Rr. Ndre Mjeda, Kompleksi rezidencial “Magnet”, Pallati Lura, njesi sherbimi nr.1017, Tiranë se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 937,460.25 (nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë pikë njëzetë e pesë) leke pa tvsh është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit me adresë: Rruga “Xhezmi Delli”, Godina nr.20, Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 1,054,054 (një milion e pesëdhjetë e katërmijë e pesëdhjetë e katër) lekë pa Tvsh siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO JO X

Nëse Po (Nr. __ Datë __ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)